



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08-6192/3

20-05-2026 20

СКОПЈЕ - SHKUP



Në bazë të nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve të projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-775/1 të datës 26.01.2026 dhe në lidhje me Programin për aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25), Qyteti i Shkupit shpall:

## THIRRJE PUBLIKE

**për financimin e aktiviteteve të projektit për përkrahjen e sipërmarrësisë së grave të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 në temën: "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse"**

### 1. LËNDA

1.1. Lënda e Thirrjes publike është financimi i aktiviteteve të projektit për përkrahjen e sipërmarrësisë së grave të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 në temën: "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse", për:

- Organizimi i trajnimeve
- Organizimi i evenimenteve
- Fushata promovuese

### 2. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

2.1. Të drejtën për pjesëmarrjeje në thirrjen publike e kanë të gjitha shoqatat civile, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare dhe agjencitë e marketingut, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet dhe Ligjin për shoqëritë tregtare, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm.

2.2. Përmes thirrjes publike, do të ndahen mjete financiare për aktivitete të projekteve për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave në Qytetin e Shkupit për vitin 2026, me temën "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse" nga pika 1, në pajtim me Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25 dhe 03/26).

### **3. AFATI KOHOR DHE MËNYRA E NDARJES SË MJETEVE FINANCIARE**

3.1. Mjetet janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026 në Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25 dhe 03/26). Përdorimi i mjeteve të ndara do të rregullohet me lidhjen e Marrëveshjes midis Qytetit të Shkupit dhe aplikantit i cili i plotëson kushtet themelore dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në Rregulloren.

### **4. KRITERET THEMELORE DHE TË VEÇANTA PËR PËRZGJEDHJEN E APLIKANTËVE**

4.1. Kriteret themelore dhe të veçanta për përzgjedhjen e aplikantëve janë të përcaktuara në Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për zbatimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve të projekteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, nr. 08-775/1 të datës 26.01.2026, e cila është publikuar në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit.

### **5. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR QË APLIKANTIT DUHET TË PARAQESË ME APLIKIMIN**

5.1. Për ndarjen e fondeve për financimin e aktiviteteve të projektit për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave në Qytetin e Shkupit për vitin 2026, me temën "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse", aplikanti detyrimisht duhet të dorëzojë shtojcat e mëposhtme:

- Fletë aplikimin e plotësuar me shkronja shtypi në alfabetin cirilik, të nënshkruar nga personi i autorizuar dhe të vërtetuar me vulën e aplikuesit (i publikuar në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Gjendjen aktuale nga Regjistri Qendror ose Aktvendimin për regjistrimin e personit juridik me seli në Shkup;
- Deklaratë të nënshkruar për detyrimet e shlyera ndaj Qytetit të Shkupit (tatimet, taksën komunale (e publikuar në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Vërtetim se nuk ka ndalesë për pjesëmarrje në procedurat e tenderimit publik, ndarjen e kontratave të prokurimit publik dhe kontratave të partneritetit publik-privat (Regjistri Qendror);
- Propozim projektin të plotësuar në mënyrë digjitale në alfabetin cirilik (i publikuar në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Plan financiar i plotësuar në mënyrë digjitale në alfabetin cirilik (i publikuar në faqen e internetit si pjesë e formularit, propozim projekti: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Portfolio profesionale – përshkrim i përvojës dhe aftësive organizative (kontratë e nënshkruar për të paktën një projekt të zbatuar në fushën për të cilën po aplikohet);
- Biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në zbatimin e projektit.

## 6. MËNYRA E ZBATIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

6.1. Për të përcaktuar përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e aktiviteteve të projektit për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave në Qytetin e Shkupit për vitin 2026, me temën "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse", Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për zbatimin e thirrjes publike për ndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve të projektit për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave në Qytetin e Shkupit për vitin 2026, me temën "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse" (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

6.2. Aplikimet që do të dorëzohen me vonesë, të parregullta (të palexueshme) ose të pa kompletuara dhe që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret, do të refuzohen nga Komisioni me një Konkluzion dhe të njëjtit nuk do të merren në konsideratë, për të cilin do të njoftohen aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

6.3. Për aplikimet që janë të kompletuara, të dorëzuara në kohë dhe të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni i dorëzon propozim Kryetarit të Qytetit për përzgjedhjen e aplikantit/aplikantëve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit/projekteve.

6.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projekteve.

### **Vërejtje:**

**- Aplikimet me dokumentacion të paplotë ose ato të dorëzuara pas afatit të caktuar nuk do të merren në konsideratë!**

**- Dokumentet e bashkëngjitura të dorëzuara nuk do të kthehen.**

**- Çdo aplikant mund të dorëzojë vetëm një aplikim për çdo thirrje publike të publikuar.**

## 7. AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

7.1. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 5 ditë nga data e shpalljes së Thirrjes Publike.

7.2. Aplikimi me të gjithë dokumentacionin duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënimin - Sektori për zhvillim ekonomik lokal - Aplikim për Thirrje publike për financimin e aktiviteteve të projektit për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave të Qytetit të Shkupit për vitin 2026, me temën: "Përdorimi i mjeteve digjitale për promovim më të madh të biznesit të grave sipërmarrëse").

7.3. Aplikantët që do të marrin pjesë në thirrjen publike do të njoftohen me shkrim për rezultatet në afatin prej 15 ditëve nga data e miratimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

7.4. Dokumentacioni i tërësishëm, fletë aplikimi për përkrahje financiare, formulari i propozimit të projektit, mund të merren në hapësirat e Qytetit të Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, baraka nr. 6, çdo ditë pune dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk).

7.5. Pyetjet për sqarim mund të dorëzohen me shkrim ose në mënyrë elektronike në Sektorin për zhvillim ekonomik lokal në adresën e mëposhtme: [Daniela.Krsteska@skopje.gov.mk](mailto:Daniela.Krsteska@skopje.gov.mk).

Kontakti: Sektori për zhvillim ekonomik lokal

Tel: (02) 3297-328



QYTETI I SHKUPIT